

5.2. Testimi fizik.

5.2.1.1 Testimi fizik është hapi i parë i konkurrimit. Ai ka si qëllim të verifikojë standardet fizike që kandidatët duhet të plotësojnë për t'u rekrutuar si ushtarë/detarë në FA.

5.2.2 Kandidatët i nënshtrohen testimit fizik në disiplinat e mëposhtme:

- vrapim 1000 m;
- ulje-ngritje mbi krahë (pompa);
- palosje-shpalosje.

5.2.3 Testimi fizik zhvillohet nën mbikëqyrjen e komisionit të testimit fizik, sipas normave të përcaktuara në **Aneksin A**, bashkëlidhur këtij udhëzimi;

5.2.4 Kandidati për ushtar/detar aktiv duhet të marrë minimumi 60 pikë për çdo disiplinë të përgatitjes fizike, për të vijuar konkurrimin e mëtejshëm.

5.2.5 Në testin fizik kandidati duhet të paraqitet me veshje sportive të siguruar prej tij (bluzë e pantallona të shkurtra/tuta) dhe këpucë sportive (atlete);

5.2.6 Testimi fizik zhvillohet në prani të ambulancës dhe ekipit mjekësor. Ai zhvillohet në disa sesione dhe për disa ditë;

5.2.7 Pas çdo sesioni të testimit fizik, kandidatët listohen sipas pikëve, duke filluar nga ai që ka marrë më shumë pikë. Listat e rezultateve, pasi firmosen nga anëtarët e komisionit, i dërgohet Komandantit të QPR-së dhe hidhen brenda ditës në Sistemin e Automatizuar të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore. Rezultatet u bëhen të ditura kandidatëve;

5.2.8 Pas përfundimit të testimit fizik nëpërmjet Sistemit të Automatizuar të Burimeve Njerëzore gjenerohet "Raporti i rezultateve të testimit fizik". Raporti përmban: nr., emrin, atësinë, mbiemrin e kandidatit, gjatësinë, gjininë (mashkull ose femër), disiplinat e testimit, normat e arritura dhe sasinë e pikëve për çdo disiplinë, pikët totale të marra në testimin fizik, si dhe statusin e kandidatit në përfundim të testimit fizik "kalues" ose "mbetës".

5.2.9 Kandidatët që rezultojnë mbetës ndërpresin konkurrimin e mëtejshëm.

(marrë nga [Udhëzim nr. 9, datë 31.12.2018, për "Procedura dhe kriteret e rekrutimit të ushtarëve/detarëve aktivë në Forcat e Armatosura"](#))